

ABSTRAKT

Ky punim trajton temën e shfrytëzimit të të drejtave të autorit në formën e tyre lëndore, duke analizuar aspektet ligjore dhe praktike të kësaj fushe në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në menyrë të veçantë trajtohen tre format lëndore të të drejtave të autorit përkatësisht: e drejta e riprodhimit, e drejta e qeradhënies së veprës, shpërndarja e veprës duke ju referuar literaturave, ligjeve të zbatueshme në RKS në aspektin teorik ndërsa praktik duke u mbështetur në rastet e mbrojtjes së tyre nga organet gjyqësore të vendit.

E drejta e autorit është degë e së drejtës, e cila i jep autorëve mbrojtje juridike për veprat e tyre nga fusha e letërsisë, artit dhe shkencës. Një mbrojtje e tillë juridike u garanton autorëve të drejtën e pronësisë dhe shfrytëzimin e veprës së tyre duke marrë parasysh të mirat pasurore që rrjedhin nga krijimtaria e tyre, duke përfshirë edhe të drejtat morale të këtyre autorëve. Vepër e autorit konsiderohet produkti shpirtëror nga fusha e letërsisë, shkencës, artit dhe fushave të tjera, pa marrë parasysh llojin dhe mënyrën e të shprehurit.

Fokusi kryesor është në kuptimin e konceptit të së drejtës së autorit, rregullimin e saj juridik në Kosovë, Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe në mekanizmat e mbrojtjes ligjore të këtyre të drejtave.

Studimi shqyrton format e shfrytëzimit lëndor të veprave autoriale, duke përfshirë riprodhimin, shpërndarjen dhe qeradhënien, si dhe sfidat që hasin autorët në mbrojtjen e krijimtarisë së tyre. Në punim është përdorur një metodologji kërkimore që kombinon analizën ligjore, shqyrtimin e literaturës përkatëse dhe studimin e rasteve konkrete për të dhënë rekomandime mbi përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të autorit.

Rezultatet e studimit theksojnë nevojën për harmonizimin e legjislacionit kombëtar me standardet ndërkombëtare dhe forcimin e mekanizmave të zbatimit për të siguruar një mbrojtje më efektive të të drejtave autoriale.

Fjalë kyçe: e drejta e autorit, shfrytëzim lëndor, mbrojtja juridike, legjislacion, jurisprudencë, mekanizmat ndërkombëtarë.